



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.02.2021, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve për mbledhjet e Komisionit për Ekonominë dhe Financat datë 17 dhe 18 shkurt 2021

2. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k., dhe “Rapiscan Systems”, INC, “Për një ndryshim në marrëveshjen e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.123/2013”, të ndryshuar”

3. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (huamarrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KFË), për programin e infrastrukturës bashkiake nr. 5, në shumën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro”

4. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Për miratimin e shtesës të kontratës “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, grupimit Morpho dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve”

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Suzana Topi, Ylli Shehu, Arben Elezi, Eljo Hysko,

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Artur Roshi dhe Reme Lala

Të ftuar:

Vasilika Vjero – Zëvendësministre në Ministrinë Financave dhe Ekonomisë

Edmond Ahmeti – drejtor i Koncesioneve

Adela Xhemali – Zëvendësministre në Ministrinë Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica – drejtoreshë e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë Financave dhe Ekonomisë

Flaures Shoshi – zëvendësdrejtor i AKUM në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elena Pici – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme

Fatmir Shehu – Drejtor Juridik në Ministrinë e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Anastas Angjeli – Mirëmëngjes të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Ndjesë që dolëm ditën e shtunë! Të gjithë kanë angazhime, por periodha e fundit e punimeve të Kuvendit është shumë ngjeshur dhe kemi shumë materiale, kështu që ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Falënderoj të ftuarit dhe përfaqësuesit e qeverisë. Falënderoj këshilltarët, që punojnë këtu non stop, me tre turne, së bashku me Elvin, të cilit duhet t'i urojmë ditëlindjen si komision: u bëfsh 100 vjeç!

Elvi – Falemnderit!

Anastas Angjeli – Sot kemi katër çështje në rendin e ditës:

-Në cilësinë e komisionit përgjegjës, kemi miratimin e procesverbalit, si gjithnjë, për mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financat për datën 17. 02. 2021.

-Në cilësinë e komisionit përgjegjës të projektligjit, kemi “Ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (huamarrësi), dhe KfË Frankfurt am Main (KfË), për programin e infrastrukturës bashkiake nr. 5, në shumën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro”.

-Në cilësinë e komisionit përgjegjës, kemi shqyrtimin e projektligjit

“Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k., dhe “Rapiscan Systems”, INC, “Për një ndryshim në marrëveshjen e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.123/2013”, të ndryshuar”.

- Në cilësinë e komisionit përgjegjës, kemi shqyrtimin e projektligjit “Për miratimin e shtesës të kontratës “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, grupimit Morpho dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve”.

Në postën tuaj elektronike keni në dispozicion të gjitha materialet.

Fillojmë me çështjen e parë: “Ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (huamarrësi), dhe KfË Frankfurt am Main (KfW), për programin e infrastrukturës bashkiake nr. 5, në shumën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro”.

Relatore është Blerina Gjylameti.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë prezent zonja Vjero, zonja Adela Xhemali, Elona Mistrovica, drejtoresha e bashkërendimit dhe sigurimit të ndihmës së huaj, si dhe zoti Flaures Shoshi, zëvendësdrejtor i AKUM-it.

Atëherë, nga përfaqësuesit e qeverisë, Ministria e Financave, zoti Flaures, a mund të na bëjë ndokush një koment në lidhje me këtë marrëveshje, para se t'ia jap fjalën relatores, zonjës Gjylameti?

Flaures Shoshi – Po, patjetër, kryetar!

Përsëritet, të nderuar deputetë!

Atëherë, qëllimi i kësaj marrëveshjeje, që është qëllimi i këtij programi, që është Infrastruktura Bashkiake 5, përfshin 7 bashki, ku përfshihen Berat- Kuçova, Elbasani, Fieri, Kamza, Lezha, Shkodra dhe Vlora.

Ky program ka si qëllim të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, por jo vetëm, pasi kemi edhe ndërhyrjet që bëhen në impiantin e ujërave të ndotura, ku bëhet fjalë për një ndërhyrje në Berat, me një vlerë rreth 7,8 milionë euro, në Lezhë dhe në Shkodër.

Përcaktimi i këtyre bashkive është bërë sipas prioriteteve të masterplanit kombëtar të ujësjellës-kanalizimeve, si dhe nevojës për investime për të mbyllur investimet e kryera në fazat e mëparshme të programit.

Konkretisht, bëhet fjalë për këto bashki, ku theksojmë se, përveç investimeve që do të vijnë nga KfW-ja, janë dhënë edhe shumë investime nëpërmjet buxhetit të shtetit, ku vlen të përmendet që, përveç investimit të KfW-së dhe buxhetit të shtetit, përfundimisht, Vlora siguron përfundimisht furnizimin me ujë 24 orë, po ashtu Shkodra, ndërsa Lezha prekë zonat bregdetare, ku është e përqendruar edhe vëmendja e qeverisë, Shëngjini, ku popullsia aktuale është 10 mijë dhe gjatë verës pothuajse pesëfishohet.

Një ndërhyrje e dukshme është edhe në Elbasan, ku, përveç projekteve të KfW-së, një vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe buxheti i shtetit dhe këto investime së bashku bëjnë që Elbasani të plotësojë të gjitha nevojat në këtë drejtim, po ashtu edhe Fieri.

Programi në vetvete implementohet në dy faza:

Faza e fizibilitetit, e cila ka kryer në dhjetor të vitit 2020.

Faza e zbatimit, ku kemi projektin, tenderin, zbatimin dhe mbikëqyrjen.

Në total, investimet në ujësjellës-kanalizime kapin vlerën e 68 milionë euro, kurse 1,5 milionë euro kemi konsulencë.

Anastas Angjeli - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Marrëveshja që ka ardhur t'u ratifikuar në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave si komision përgjegjës ka për qëllim që të ratifikohet si marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që është huamarrësi dhe KfW Frankfurt për financimin e programit "Infrastruktura Bashkiake 5".

Kjo hua prej 80 milionë euro merret në kuadër të programit “Infrastruktura Bashkiake 5”, baza e së cilës është marrëveshja e datës 11 tetor 2019, ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Ky program ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave, si dhe përmirësimin e treguesve të performancës për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, të një sërë bashkive si Shkodër, Lezhë, Kamëz, Kuçovë, Elbasan, Fier dhe Vlorë. Përzgjedhja e këtyre bashkive si përfituese nga programi është bërë bazuar në prioritetet e vetë qeverisjes, si dhe të masterplanit kombëtar të Ujësjellës-Kanalizimeve, por duke vlerësuar mbi të gjitha nevojën për përmylljen e investimeve tashmë të kryera në fazat e mëparshme të programit.

Gjithashtu synohet dhe përmirësimi i aksesit dhe qëndrueshmërisë të trashëgimisë kulturore, pasurive natyrore, si dhe përmirësimi i infrastrukturës në të gjithë territorin e vendit, në kuadër të planeve zhvillimore lokale dhe kriteret e vijueshmërisë së këtij programi.

Për sa më sipër dhe duke marrë parasysh faktin e ndikimit që do të ketë në jetën e një sërë qytetarësh dhe mbi të gjitha në përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve të bashkive kryesore që janë si qendra zhvillimore edhe të turizmit në Shqipëri, i propozoj komisionit miratimin e këtij projektligji.

Faleminderit!

Anastas Angjeli - Faleminderit, zonja Gjylameti!

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, a kanë ndonjë gjë për të shtuar?

Zonja Vjero? Zonja Xhemali?

Vasilika Vjero – Jo, zoti Angjeli, nuk kemi komente shtesë.

Adela Xhemali – A mundem? Kam unë një koment.

Anastas Angjeli – Po, zonja Xhemali.

Adela Xhemali – Dëshiroj të shtoj një informacion se kjo fazë bashkëfinancohet edhe nga Birra “Amstel” për një total prej 45,6 milionë eurosh. Sot po kalojmë një kredi, por totali i këtij programi vjen në koston 155 milionë euro, pra është 80 milionë euro kredia, 40 milionë euro grante dhe pjesa tjetër nga buxheti i shtetit që mbulohet tvsh-ja dhe kostot lokale.

Anastas Angjeli - Faleminderit, zonja Xhemali!

Zoti Shoshi, a mund të na i ndani shumat me bashki sipas asaj që thamë në fillim?

Flaures Shoshi - Po, ashtu siç e tha dhe zonja Xhemali, me gjithë garantin bashkë apo...

Anastas Angjeli - Me gjithë grantin. Nëse i keni të ndara, na tregoni sesi shkojnë për secilën bashki që është përfshirë në projektin 5.

Flaures Shoshi – Po, patjetër.

Po filloj me Kuçovën: për sistemin e furnizimit me ujë 2,5 milionë euro. E njëjta shumë 2,5 për kanalizimet. Për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura shkon në një vlerë 7,8 milionë euro, që zgjidh komplet qytetin e Beratit.

Për qytetin e Elbasanin, kemi për furnizimin me ujë 12,8 milionë euro, një shumë goxha e konsiderueshme dhe 1 milionë euro për kanalizimet e ujërave të ndotura.

Për qytetin e Fierit kemi 10 milionë euro për furnizimin me ujë dhe 3,5 milionë euro për kanalizimet e ujërave të ndotura.

Për Kamzën kemi 7,2 milionë për ujësjellësin dhe 66 milionë për kanalizimet e ujërave të ndotur.

Për qytetin e Lezhës kemi 7,5 milionë euro për ujësjellësin dhe 3,7 për kanalizimet, si dhe 9 milionë që futet për impiantet e trajtimit për ujërat e ndotura.

Për qytetin e Shkodrës kemi 10 milionë euro për sa i përket furnizimit me ujë, 2 milionë euro për trajtimin e ujërave të ndotura, kurse 7,5 milionë euro janë për impiantin e ri që do të ndërtohet për qytetin e Shkodrës.

Dua të theksoj dhe një gjë që në Shkodër përveç 7,5 milionë eurove që është impianti, ka mbaruar impianti i trajtimit të ujërave të ndotura, i cili është komplet për zonën turistike, pra pjesa e Velipojës është e zgjidhur. Vlora ka një shumë totale prej 18 milionë eurosh dhe i gjithë ky investim është futur vetëm për furnizimin me ujë. Kurse për sa u përket kanalizimeve janë disa faza më përpara, që janë bërë nga KfW-ja dhe nga buxheti i shtetit dhe janë në zbatim e sipër.

Kjo është shuma totale që ka për secilën.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Shoshi!

Flaures Shoshi – Faleminderit, zoti kryetar!

Anastas Angjeli - A ka kush pyetje?

Edlira ka pyetje.

Fjala për Edlirën.

Edlira Hyseni – Unë një pyetje të thjeshtë kisha.

Një ndër objektivat që parashtrohet edhe në relacion është përmirësimi i treguesve të performancës të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në këto qytete, ku do të investohet. Meqenëse pak a shumë jemi në dijeni që ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të gjitha me humbje, të paktën këtej nga Durrësi deri vonë kështu ka qenë, ku mendoni se do të shkojnë këto fonde për të përmirësuar performancën e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, qoftë në shtrirjen e bazës së arkëtueshme, të tatimpaguesve, pra të atyre që duhet të paguajnë

shërbimin, ndërkohë që mosarkëtimi i të ardhurave është një problem i ujësjellësit, qoftë në kostot e larta që ato kanë për energjitë elektrike? Me sa unë di ujësjellësit, të paktën në Durrës, koston më të lartë ia jep energjia elektrike, që lidhet me përdorimin e pompave. Si mendoni se këto fonde mund të përmirësojnë performancën financiare të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, përtej infrastrukturës që do të ndërtohet?

Anastas Angjeli – Faleminderit Edlira!

Edlira Hyseni – Faleminderit!

A ka pyetje tjetër?

Zoti Shoshi, do të përgjigjeni ju?

Flaures Shoshi – Patjetër.

Antoneta Dhima – A mund të bëj një pyetje kryetar?

Anastas Angjeli – Të përgjigjet ai, pastaj bëni pyetje.

Flaures Shoshi – Faleminderit, zonja Hyseni!

Pyetja është shumë më vend, se të gjitha këto investime ndër vite, sidomos këto 30 vitet e fundit, por edhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve vazhdojnë të jenë një gropë e madhe për buxhetin e shtetit dhe normalisht kjo sa vjen në rëndohet. Këto vitet e fundit, sidomos Durrësi, zonja deputete, ka marrë një sërë investimesh për sa u përket stacioneve të pompave të Fushë Kuqes, të cilat janë rinovuar, dhe energjia nga 1.1 milionë euro, që ka qenë në muaj është reduktuar gati në 750 mijë euro, domethënë është ulur me 1/3-n. Kryesorja është që ne po investojmë edhe te linja kryesore nga Fushë Kruja, deri në Durrës, e cila, e thënë në gjuhën popullore, ka qenë si një kullojë për efekt të 30 viteve dhe të lëvizjeve demografike. Kur ka pasur lëvizje demografike të gjitha familjet kanë dashur të furnizohen me ujë dhe etapat, që kanë kaluar këto 30 vjet, kanë bërë që këto sisteme pothuaj të vetëshkatërrohen. Të gjitha investimet janë bërë nga zero dhe përveç investimeve të KfW-së, jo më larg se para një jave, ne kemi kaluar, në veçanti për qytetin e Durrësit, edhe 3 investime të tjera në zonat 4, 2 dhe 1, që i kemi ndarë si masterplan, për furnizimin me ujë deri te abonenti familjar, që është me matës. Në momentin që investojmë dhe në momentin që do të përfundojnë, se kur ulen humbjet do të rritet presioni, do të rritet sasia e ujit, se ky është koncepti, dhe, duke ulur humbjet, do të kemi furnizim më të mirë të ujit nëpër shtëpi, por do të ulët dhe konsumi, plus që kemi edhe pompat.

Presim që brenda një 2-vjeçari, me të gjitha këto investime që ka dhënë AKUM-i, duke prekur pothuajse çdo fshat të Shqipërisë, të kemi një ndryshim rrënjësor. Më vonë do të jenë bashkitë ato që nëpërmjet një projektligji që do të bëhet dhe disa vendimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Transporteve do të përgjigjen një më një për të gjitha investimet nga buxheti i

shtetit. Në qoftë se bashkitë nuk i duan, siç ka thënë AKM-ja, atëherë do t'i marrë qeveria dhe do t'i administrojë.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Shoshi!

Po, Antoneta.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit zotit Shoshi për prezantimin!

Unë kam një pyetje.

Në fakt, ne morëm informacionin që nëpërmjet ratifikimit të kësaj marrëveshjeje do të përmirësohet sistemi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, dhe në fjalën e tij zoti Shoshi theksoi se për qytetin e Fierit do të financohen 10 milionë euro për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe 3,5 milionë euro për kanalizimet e ujërave të zeza. Doja të dija, me financimin 10 milionë euro do të përfundojë sistemi i furnizimit me ujë në të gjithë territorin e Bashkisë së Fierit? Vlera 3,5 milionë euro, që do të akordohen për pastrimin e kanalizimeve të ujarëve të zeza, çfarë do të përfshijë?

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Po, zoti Shoshi.

Flaures Shoshi – Faleminderit, kryetar!

Zonja deputete, faleminderit për pyetjen!

Do t'i bie pak shkurt për sa i përket Fierit. Fieri, me të gjitha këto investime, aktualisht është mirë për sa i përket furnizimit me ujë, por këto 10 milionë euro financime të garantoj që Fierin do ta përmirësojnë 100%, sepse Fieri është tashmë në fazën e përmirësimit. Dua të them vetëm diçka të vogël. Po ndërtohet spitali që është jashtë qytetit të Fierit. Të gjitha këto investime kanë bërë që rrjeti të përfshihet dhe jashtë qytetit të Fierit dhe spitalin e ri, të cilin pak më parë askush nuk e dinte se ku do të ndërtohej, është dashur vetëm 3 ditë për ta furnizuar me ujë nga linjat më të afërta me qytetin. Kjo do të thotë që investimet janë shtrirë kaq shumë sa dhe kemi kaluar në periferi. Me shumën 10 milionë euro do të mbulohen të gjitha nevojat që ka qyteti, por edhe rrethinat përreth tij. Kjo ishte pak a shumë për sa i përket furnizimit me ujë.

Për sa i përket shumës 3,5 milionë euro për kanalizimet, normalisht që ne kemi bërë një fazë fizibiliteti para, është kërkuar mendimi i bashkisë, i ndërmarrjes së ujësjellësit, se ku janë të gjitha defektet, do të shikohet prapë projekti dhe normalisht që do të mbulohet gjithë qyteti dhe rrethinat e tij. Ta dhashë shembullin e spitalit për sa i përket furnizimit me ujë, se 3 ditë u deshën për ta lidhur ujin me spitalin. Kështu që është...

Antoneta Dhima – Shumë faleminderit!

Unë jam koshiente që në kohë rekord... *(Nuk dëgjohet)* spitalin e ri "Memorial", Fier.

Anastas Angjeli – Faleminderit, Shoshi!

Faleminderit, Antoneta!

Nuk ka ndonjë gjë tjetër.

Para se të kalojmë në votimin e kësaj marrëveshjeje, kam një sugjerim. Ndoshta shuma e shprehur e kredisë nuk duhet në të njëjtën kohë edhe në titull, edhe në nenin 1, kështu që ekspertët ta shikojnë këtë punë.

Para se të kalojmë në votim po bëj edhe një herë apelin: Anastas Angjeli, këtu, Arben Elezi, këtu, Antoneta Dhima, këtu, Blerina Gjylameti, këtu, Ervin Bushati, këtu, Rolant Xhelilaj, këtu, Xhevit Bushaj, këtu, Reme Lala nuk është, Senida Mesi, këtu, Elio Hysko nuk është, Vullnet Sinaj nuk është, Edlira Hyseni, këtu, Krenar Rryçi, këtu, Artur Roshi nuk është, Korab Lita, këtu, Ylli Shehu këtu.

Siç shihet, shumica është prezent, ka vetëm 2-3 mungesa.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, huamarrësi, dhe KFË Frankfurt am main (KFW), për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro”.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim marrëveshja.

Neni 1. Kush është dakord me nenin 1, meqenëse shuma është në titull, le ta lëmë edhe në titull, edhe në nen? Kundër? Abstenim? Një votë abstenim nga zonja Topi.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Zonja Topi është abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin e projektit në tërësi.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim? Zonja Topi është abstenim.

Miratohet në tërësi marrëveshja.

Me miratimin e kësaj marrëveshjeje, me projektin V, bëhet një hap akoma më i madh para për furnizimin e popullsisë 24 orë me ujë të pijshëm në të gjithë territorin e vendit. Siç e dëgjuat, një numër bashkish: Elbasan, Vlorë, Fier, Kuçovë, Berat, Lezhë, Shkodër janë pjesë e këtij projekti të madh. Kjo do të rrisë aksesin e popullsisë dhe në të njëjtën kohë edhe cilësinë, standardin e furnizimit me ujë të pijshëm, natyrisht edhe kostot e të gjitha problemeve që u ngritën këtu nga deputetët.

Faleminderit!

Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Transportit, të cilët janë autorët e këtij projekti, kanë sjellë kontratën e kredisë me etiketimin sipër “draft”. Në bazë të legjislacionit në fuqi pjesa “draft” duhet hequr dhe duhet ta risillni, sepse nuk shkon dot te Presidenti i Republikës dhe as botohet në Fletoren Zyrtare.

Më jepni pak ta shohin Vasilika dhe të tjerët.

Nuk mund të botohet në Fletoren Zyrtare dhe nuk mund të shkojë te Presidenti i Republikës për firmë “draft”, kështu që ditën e hënë në mëngjes dorëzojeni në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave pa pjesën “draft”.

Faleminderit!

Kryetar I Komisioni

Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.2.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k., dhe “Rapiscan Systems”, INC, “Për një ndryshim në marrëveshjen e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Suzana Topi, Ylli Shehu, Arben Elezi dhe Eljo Hysko.

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Artur Roshi dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Vasilika Vjero – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Adela Xhemali – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Edmond Ahmeti – Drejtor i Koncesioneve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica – Drejtoreshë e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave

Anastas Angjeli – Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, e cila është shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k., dhe “Rapiscan Systems”, INC “Për një ndryshim në marrëveshjen e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013”, të ndryshuar””.

Relator i këtij projektligji është zoti Ervin Bushati. Nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të pranishëm janë zonja Vjero, zëvendësministre dhe zoti Edmond Ahmeti, drejtor i Koncesioneve.

Fjalën e kanë përfaqësuesit e qeverisë për të na shpjeguar arsyet e ndryshimit që bëhet në kontratën koncesionit.

Fjala për ju zonja Vjero.

Vasilika Vjero – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Qëllimi i këtij projektligji ka të bëjë me lehtësimin e barrës financiare buxhetore jo vetëm gjatë buxhetit të vitit të kaluar 2020, por njëkohësisht edhe për buxhetin aktual të vitit 2021.

Në fakt, ky projektligj vjen edhe në vijim të dy akteve normative, të cilat janë miratuar gjatë vitit të kaluar, konkretisht aktet normative nr. 15 dhe nr. 28 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar””, në zbatim të të cilave u aplikuan dhe u miratuan një sërë shkurtimesh drastike në të ardhura dhe shpenzime, kjo edhe si rezultat i periudhës së pandemisë me të cilën u përballëm në atë kohë, por që ende vijon.

Ashtu sikurse edhe ju jeni në dijeni u shkurtuan një sërë financimesh, të cilat lidheshin me pagesat koncesionare, më konkretisht u shkurtua pagesa për koncesionin Rapiscan në masën 400 milionë lekë. Kjo u miratua me aktet normative, por ndërkohë për t’u bërë efektive dhe për të marrë edhe miratimin për mënyrën se si këto pagesa do të mundësoheshin më tej nga buxheti në drejtim të kompanive koncesionare, ministrja e Financave krijoi një grup pune dhe inicio të gjithë procedurën ligjore që me krijimin grupit të punës, për të parë mundësinë e negociimit të kësaj marrëveshjeje koncesionare.

Në fakt, ka qenë një...(nuk dëgjohet) e grupit të punës dhe e grupit të mandatuar nga ministria, e cila ka filluar që prej muajit prill deri në fund të vitit kanë ardhur disa propozime nga

shoqëria koncesionare për mënyrën si këto të ardhura të munguara do të mund t'u ripaguheshin atyre në kohë. Pra, ata kanë sjellë disa variante, të cilat janë të shpjeguara, në fakt, edhe në relacion. Është e rëndësishme të themi se, pas një negocimi të mirë dhe të gjatë me kompaninë koncesionare, është marrë edhe miratimi i tyre për shtyrjen 100% të pagesës së kësteve të tarifës së shërbimit për pikat e operimit për muajt shtator, tetor, nëntor nga tarifa vjetore e shërbimeve të pikës së operimit për vitin 2020. Pra, nëse më përpara kompania kërkonte shtyrje vetëm 50% me 50% të pagesës dhe fillim pagesash edhe gjatë vitit të kaluar, pas gjithë këtyre negociatave është vendosur që e gjithë shuma prej 400 milionë lekësh, e cila nuk iu dha kompanisë në kohë, do të fillojë t'i jepet duke filluar që nga viti i ardhshëm, pra që nga data 1 janar e vitit të ardhshëm deri në datën 31 dhjetor. Të gjitha këto këste të munguara do t'i jepen si pjesë e kësteve mujore në vijimësi kompanisë. Bëhet fjalë për pagesë në mënyrë proporcionale në shumën 279 mijë e 572 euro çdo muaj mbi këstin e rregullt mujor të tarifës së shërbimit për pikat e operimit të kësaj kontrate.

Ministria e Financave mendon se ka arritur të ketë një marrëveshje të mirë të negociuar mirë, e cila pa diskutim i ka dhënë frymëmarrje buxhetit gjatë vitit të kaluar, por njëkohësisht edhe gjatë vitit aktual. Sigurisht, kemi gjetur mirëkuptimin e kompanisë, e cila ka rënë dakord për marrjen me vonesë të këtyre kësteve dhe në një mënyrë proporcionale, siç është dakordësuar në këtë marrëveshje.

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Zoti Bushati, si relator, e ka fjalën.

Ervin Bushati – Të gjithë e dimë që ky ka qenë një vit i vështirë që kur ka nisur, madje më shumë se është i vështirë, me evente jashtë kontrollit të çdo kapaciteti qeverisës ose edhe ligjvënës, ndaj çdo vendimmarrjeje e tillë, që ndihmon jo vetëm ekonominë shqiptare dhe financat, por edhe funksionimin normal të jetës sociale në vendin tonë është e mirëpritur. Unë dua të jem mirënjohës me kompaninë. Është bërë një punë shumë e mirë edhe nga institucioni përkatës, që është marrë dhe ka negociuar dhe shpresoj që marrëveshjet të tilla, në fakt, të lidhen edhe me kompani të tjera, të cilat, patjetër, që e kanë të lidhur aktivitetin e tyre të punës, mirëqenien, por edhe të ardhurat me Republikën e Shqipërisë dhe me operatorët ekonomikë shqiptarë, pra firmat private. Të gjithë bashkë jemi në të njëjtën betejë, që në këtë luftë me pandeminë, në këtë luftë globale me sfidën ekonomike, që kemi ta kuptojmë që do të funksionojmë dhe do të dalim të gjithë bashkë, si një aksion i përbashkët, pra një trup i vetëm për të shpëtuar ekonominë. Ndaj, është në të mirën e kompanisë, pra të Rapiskan-it, që të ndihmojë operatorët ekonomikë privatë shqiptarë, të ndihmojë qeverinë, në të gjitha kontratat, në rastet e tërmeteve, të zjarreve, sepse kjo është një situatë e paparashikueshme. Kjo është lufta jonë e

përbashkët. Ky është një buxhet lufte. Këto janë masa lufte. Ndaj shpresoj se marrëveshje të tilla të lidhen edhe me kompani të tjera, të cilat mund të lehtësojnë sadopak jo thjesht buxhetin e shtetit, por funksionimin, pra frymëmarrjen, t'i japin oksigjen ekonomisë shqiptare në një moment kaq të vështirë. Ndaj, e falënderoj ministrinë dhe duhet t'i jemi mirënjohës për kompaninë që e mirëkupton këtë dhe shpresoj që në të ardhmen të kemi edhe disa kontrata të tjera, ndoshta të jenë në një paketë dhe të quhet paketa e ndihmës ndaj bizneseve shqiptare, për biznesin shqiptar nga bizneset shqiptare.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Bushati!

Ka pyetje? Zonja Edlira, po.

Edlira Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, këtë çështje këtej në Durrës e njohim mirë. Është një kontratë koncesionare fort e diskutuar dhe, meqenëse është në diskutim dhe rishikim...

Anastas Angjeli – Zonja Edlira, direkt pyetjen, të lutem.

Edlira Hyseni – Jo, do të më lejoni ta bëj pyetjen bashkë me opinion, të lutem, se nuk do të flas dy herë, një herë dhe do ta përmbledh.

Ervin Bushati – Opinioni është në fund.

Anastas Angjeli – Dakord, por që...

Edlira Hyseni – Do ta bëj pyetjen, në fakt. Atëherë, desha të thosha që e njohim si kontratë dhe është e rëndësishme, por ndryshe nga vlerësimi që i bëri kolegu parafolës, të cilin e falënderoj, unë mendoja që, meqenëse është një kontratë koncesionare, e cila i ka rënduar goxha kostot e transportit dhe është bërë në vitin 2013, në fakt, nga qeveritë paraardhëse, jo nga kjo aktuale...

Anastas Angjeli – Është ndryshuar një herë nga qeveria aktuale, se është përgjysmuar kostoja.

Edlira Hyseni – Në vitin 2015 është bërë një rishikim...

Po, po.

Anastas Angjeli – Duhet ta thuash edhe këtë, prandaj.

Edlira Hyseni – Prandaj, unë sinqerisht do të kisha vlerësuar nëse *Rapiscan*-i do të kishte bërë ndonjë falje 50% të kësteve që i detyrohet ose ndonjë kontribut për ta rimëkëmbur qeverinë në këtë kohë krize, pra të kishte edhe ndonjë kontribut konkret, duke ulur diçka nga detyrimi që pret të marrë sesa të shtyjë.

Gjithsesi, pyetjet e mia janë: meqenëse është ngritur një grup pune që, siç e tha edhe zëvendësministrja, ka punuar gjatë nga prilli deri në dhjetor, pra ka pasur goxha muaj në

dispozicion për të diskutuar rreth këtij shërbimi që ofrohet në këtë kontratë koncesionare, doja të dija nëse ky grup pune ndërkohë që ka negociuar për çështjen e pagesës, a ka pasur mundësi të verifikojë edhe objektin e kësaj kontrate? Meqenëse është në fuqi dhe në detyrimin edhe të qeverisë të kontrollojë se si shkon ecuria e këtyre kontratave, për të kuptuar nëse objekti thelbësor, që është ofrimi i shërbimit të skanimit të mjeteve që hyjnë në doganë, realizohet efektivisht. Sepse janë miliona euro, se edhe te ne sot nuk u fol, por flasim për 3,3 milionë euro për tri muaj që janë tri kështet mujore plus diçka, një diferencë që ka ngelur nga gushti. Pra, rreth 1 milion e ca euro paguhen çdo muaj nga biznesi për këtë kontratë koncesionare nëpërmjet doganës, e cila i mbledh si agjent tatimor dhe duke mbajtur më pas komisionin.

Por, meqenëse në praktikë ne e dimë që ky është një lloj shërbimi që tarifohet dhe paguhet nga biznesi, por në të shumtën e rasteve nuk realizohet (pra është një shërbim që shpesh nuk kryhet), a ka pasur mundësi grupi i punës të verifikojë në praktikë nëse ky koncesionar e bën punën për të cilën paguan biznesi? Sepse ju siguroj që në praktikë një anije që vjen me qymyr dhe shkarkohet në 20 mijë tonë në njëmijë kamionë, për çdo deklaratë doganore tarifohen 22,5 euro nga sistemi doganor, e bën e automatikisht, biznesi e paguan, por skanimi nuk bëhet. Pra, vërtet jemi në një rishikim kontrate që lidhet vetëm me kohën e pagesës, nuk kemi rishikim të objektit, por meqenëse grupi i punës punon gjatë do të ishte mirë të ...

Nuk e di nëse kontrata parashikon një llogaridhënie lidhur me kushtet se si po ekzekutohet ky shërbim, po tarifohet në mënyrë të drejtë, po realizohet apo është fiktiv dhe nëse ka masa që mund të merren nëse konstatohet që ka gjëra që nuk shkojnë. Ju siguroj që ky koncesion u kushton jo vetëm bizneseve shqiptare miliona euro në muaj, por e bën portin e Durrësit rreth 22% më të shtrenjtë sesa ata të rajonit, sepse gati një euro për ton i shkon vetëm skanimi. Ky është një shërbim që e ka revoltuar goxha edhe biznesin, i cili e konsideron ende të padrejtë.

Pra, unë dua të di nëse grupi i punës ka hyrë në të tilla verifikime thelbësore. Meqenëse po i shikojmë, mirë është të verifikojmë nëse puna po kryhet dhe nëse ai koncesionar e meriton t'i marrë ato lekë. Gjithashtu, doja të shprehja edhe një herë idenë time që Rapiskan do të bënte mirë të kontribuonte në rimëkëmbje duke dhuruar diçka ose duke lënë gjysmën e kësteve dhe jo ta pretendojë thjesht shtyrjen.

Së fundi, pse muaji dhjetor nuk është përfshirë në këtë llogaritje? Është paguar dhjetori, përderisa flitet vetëm për tre muaj, shtator, tetor, nëntor dhe diçka që ka ngelur nga gushti? Do të thotë që dhjetori është i paguar?

Faleminderit!

Shpresoj që kjo kontratë të anulohet apo të rishikohet në ulje të tarifave për biznesin.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, Edlira!

Po, zonja Vjero.

Vasilika Vjero – Faleminderit, kryetar!

Për sa i përket pyetjes së parë, ndryshimi i kësaj kontrate nuk ka pasur si objekt të rishikojë punën e koncesionarit apo të vlerësojë mënyrën se si koncesionari operon në të gjitha pikat e shërbimit. Qëllimi ka qenë që si rezultat i pandemisë dhe i shkurtimeve buxhetore koncesionari jo vetëm të pranonte që të mos paguhej, por njëkohësisht të pranonte që edhe kjo pagesë të mund të shtyhej në kohë, propozim që ka ardhur pranë jush.

Për mënyrën se si monitorohet koncesionari, dua t'ju bëj me dije se në vijim të kësaj kontrate koncesionare ka një urdhër të mirë papërcaktuar të ministrit të Financave, ku janë të ngarkuara strukturat doganore për të monitoruar çdo lloj problematike që lidhet me këtë koncesion.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet pikave të saj ku janë të vendosura pajisjet e skanimit, pa diskutim që ka grupe pune, verifikon çdo përdorim të pajisjeve, sepse është ajo që në fund miraton edhe pagesat që i jepen shoqërisë koncesionare. Për pjesën e kontrollit dhe mënyrës se si ky koncesion funksionon në realitet ka një strukturë të dedikuar që është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Për sa i takon pyetjes suaj të dytë, që lidhet me muajin dhjetor, dhjetori, në fakt, nuk është përfshirë, pasi ai paguhet në muajin janar. Pra, do të fillojë në vitin buxhetor që fillon me muajin janar pasardhës.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Vjero!

Ka tjetër?

Zoti Bushati.

Ervin Bushati – Kalojmë në votim, mendoj unë.

Anastas Angjeli - Atë e caktoj unë, mos u shqetëso.

Thashë mos kishe ndonjë replikë me zonjën Edlira, meqë nuk ishte dakord me ty.

Mirë, votojmë miratimin e marrëveshjes “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k., dhe “Rapiscan Systems”, INC, “për një ndryshim në marrëveshjen e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.123/2013”, të ndryshuar”.

Kush është pro në parim për projektin? Ju lutem, aksesoni, votoni. Abstenim? Krenari me Edlirën abstenim. Kundër? Nuk ka.

Faleminderit!

Neni 1. Kush është dakord me nenin 1? Faleminderit! Abstenim? 2 abstenime. Kundër?
Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Hyrja në fuqi. Kush është dakord? Faleminderit! Abstenim? 2 abstenime.
Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Votojmë në tërësi ligjin. Kush është dakord? Faleminderit! Abstenim? 2 abstenime.
Kundër? Nuk ka.

Faleminderit!

Miratohet edhe në tërësi projekti

Kryetar I Komisioni

Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 20.02.2021, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Për miratimin e shtesës të kontratës “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit Morpho dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve”

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Suzana Topi, Ylli Shehu, Arben Elezi, Eljo Hysko,

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Artur Roshi, Reme Lala

Të ftuar:

Elena Pici – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme.

Fatmir Shehu – Drejtor Juridik pranë Ministrisë së Brendshme.

Anastas Angjeli – Kalojmë te çështja e tretë, që ka të bëjë me projektligjin “Për miratimin e shtesës të kontratës “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të

pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit Morpho dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve””.

Relator për këtë çështje jam caktuar unë. Nga qeveria kanë ardhur përfaqësues nga Ministria e Financave dhe, gjithashtu, nga Ministria e Brendshme kemi zonjën Elena Pici, sekretare e përgjithshme dhe Fatmir Shehu, drejtor juridik.

Fjala për përfaqësuesit e qeverisë. Kush do ta marrë fjalën Ministria e Financave apo Ministria e Brendshme?

Po, nga Ministria e Brendshme.

Elena Pici – Po, zoti kryetar.

Të nderuar deputetë, autori kontraktor Ministria e Brendshme ka të lidhur me grupin e subjekteve të përbëra nga *Idemia Identity, Security France* dhe Fondin Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve, kontratën e koncesionit për prodhim dhe shpërndarje të kartave të identiteti dhe të pasaportave elektronike që është i ratifikuar me ligjin 9972 të vitit 2008 dhe që është ndryshuar në vitin 2010 dhe në vitin 2013. Ndryshimi që sjellim për shqyrtimin tuaj sot, në fakt, përcakton dy lehtësira të rëndësishme për qytetarët të cilat vijnë pa kosto shtesë për qytetarin, pa implikime buxhetore financiare për autoritetin kontraktor dhe pa benefite shtesë për koncesionarin. Ndryshimi i parë konsiston në përdorimin e shërbimeve digjitale për verifikimin e identitetit në procesin e aplikimit për dokumentet e identitetit, në përputhje me ligjin nr.9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, i cili është i parashikuar në shtojcën 23 dhe është pjesë integrale e kësaj kontrate. Ky ndryshim ka ardhur si kërkesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila ka konstatuar me shumë vlerë që konsujt gjatë punës së tyre, që bëjnë me aplikimin me letërnjoftime elektronike për shtetasit shqiptarë që ndodhen jashtë vendit, të mos operojnë vetëm me shkresa fizike, por t’u njihet nënshkrimi i tyre elektronik. Kjo do të sjellë një lehtësim të procesit të aplikimit për shtetasit shqiptarë që aplikojnë për letërnjoftime elektronike jashtë Republikës së Shqipërisë.

Dua të theksoj se vetëm në muajt janar dhe shkurt të vitit 2021 Ministria e Brendshme në bashkëpunim me koncesionarin dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme kanë mundur hapjen e 6 zyrave të reja aplikimi për letërnjoftime elektronike pranë zyrave tona konsullore në Stamboll, Vjenë, Bari, Stokholm, Paris dhe Berlin.

Së fundi, është e rëndësishme për t’u përmendur se mbulimi i kostove për mirëmbajtjen e platformës e-Trust, që do të ofrojë shërbimin e nënshkrimit elektronik, do të mbulohet nga koncesionari pa kosto shtesë.

Ndryshimi i dytë vjen si rrjedhojë i ndryshimeve që ka miratuar parlamenti shqiptar me ligjin nr. 89/2020, datë 09.07.2020 “Për një shtesë në ligjin “Për letërnjoftimin elektronik të

shtetasve shqiptarë”, ku Kuvendi i Shqipërisë në muajin korrik parashikoi një lehtësi për target grupin e shtetasve mbi moshën 75 vjeç, duke marrë parasysh vështirësitë e tyre për të lëvizur, moshën dhe kushtet e pandemisë, i cili ishte një vit i vështirë, ku përkonte me periudhën e mbarimit të vlefshmërisë së ID kartave dhe nevojën e tyre për t’u rinovuar. Pra, ishte Kuvendi i Shqipërisë që miratoi këtë ndryshim, i cili parashikonte se për shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 75 vjeç letërnjoftimi lëshohet pa afat. Ndryshimi i këtij ligji solli nevojën e këtij parashikimi edhe në kontratën koncesionare, ku, deri sot, për të gjithë shtetasit afati i vlefshmërisë së ID kartës ishte 10 vjet, por nëpërmjet ngritjes së grupit negociator, i cili mundësoi parashikimet e ndryshimeve në kontratë, sot ID karta për shtetasit mbi 75 vjeç do të lëshohet me një afat 50-vjeçar. Duke qenë se nga aspekti teknik ishte e nevojshme vendosja e një afati, u gjykua që ky afat, 50 vjet, përkon me maksimumin e jetëgjatësisë së shtetasve në Republikën e Shqipërisë, duke plotësuar detyrimin e parashikuar në ligjin e miratuar nga Kuvendi në muajin dhjetor. Të gjitha këto parashikime do të jenë pjesë e shtojcës 24, pjesë integrale e kontratës.

Dua të theksoj sërish që ky ndryshim do të bëhet pa kosto shtesë për autoritetin kontraktor, nuk do të sjellë ndryshim të çmimit të ID kartës që do të paguajnë qytetarët, i cili vazhdon të jetë 1500 lekë, dhe nuk sjell asnjë lloj benefiti për koncesionarin, i cili, përkundrazi, ka marrë përsipër ta kryejë këtë ndryshim brenda afatit 2-mujor të miratimit të ndryshimit të kësaj kontrate me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë.

Sipas parashikimeve të nenit 10 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” të ndryshuar, ka kaluar për mendim në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, duke i bashkëlidhur raportin cilësor dhe sasiore të riskut për implikimet financiare. Pra, duke qenë se Ministrinë e Financave ka vlerësuar dhe shprehur dakordësi se ndryshimi i kontratës nuk paraqet risk financiar, dhe ashtu siç përmenda disa herë, kjo përveçse sjell benefite për qytetarët, nuk sjell kosto shtesë për ta, nuk sjellë kosto shtesë për autoritetin kontraktor, ndërkohë koncesionari ka të gjitha mundësitë që t’i implementojë këto ndryshime të përmendura, ju lutem ta miratoni këtë ndryshim, i cili do të sjellë vetëm dy benefite për qytetarët.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Pici!

Edhe unë si relator, me gjithë shpjegimin shterues që sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Brendshme bëri për këtë projekt dhe për këtë ndryshim që i bëhet kësaj kontrate për kartat e identitetit, duke qenë se janë dy elemente të rëndësishme, elementi që ka të bëjë me moshën 75 vjeç për shtyrjen e afatit dhe elementi i dytë që ka të bëjë me rritjen e elementeve të sigurisë, duke futur disa elemente të reja teknologjike në përdorimin e kartave, besoj se, po t’i

shtojmë kësaj edhe faktin se nuk kemi as kosto shtesë, as përfitime dhe nuk kemi asnjë shqetësim, përkundrazi, kemi marrje përsipër nga ana e koncensionarit të këtyre dy çështje, ju ftoj të gjithëve ta votoni.

A ka njeri pyetje dhe diskutime? Nuk ka.

Meqenëse nuk ka pyetje dhe diskutime, e votojmë në parim projektligjin “Për miratimin e shtesës së kontratës “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit *Morpho* dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve” .

Kush është dakord? Faleminderit! Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votimin në tërësi projektligjin.

Kush është dakord? Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet në tërësi.

Edhe një herë faleminderit dhe ndjesë që ju nxorëm ditën e shtunë, por ngarkesa e ka bërë këtë. Faleminderit dhe mirë u takofshim në mbledhjen e ardhshme, e cila do t’ju vihet në dispozicion me postën elektronike. Faleminderit këshilltarëve dhe përfaqësuesve të qeverisë që ishin me ne sot dhe na mbështetën në të gjithë këtë diskutim.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Fundjavë të mbarë!

Anastas Angjeli – Fundjavë të mbarë të gjithëve, duke punuar sa më shumë!

MBYLLET MBLEDHJA

Kryetar I Komisioni

Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti